

D E K R E T
Nr.1396, datë 7.3.1996

PËR VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANEVE DHE PIJEVE ALKOOLIKE

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Artikujt e duhanit dhe pijeve alkoolike që prodhohen dhe tregtohen në vend ose importohen, të pajisen detyrimisht me pullë.

Neni 2

Pulla është letër me vlerë dhe monopol i shtetit.

Neni 3

Artikujt e duhanit dhe pijeve alkoolike që tregtohen pa pullë pas hyrjes në fuqi të këtij dekreti, sekuestrohen nga policia tatimore dhe ajo doganore, si dhe personat përgjegjës dënohen për kundërvajtjen administrative.

Në rast përsëritjeje, përveç sekuestrimit, personi përgjegjës dënohet edhe për kundërvajtje penale me 2 vjet burg.

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij dekreti.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha